



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202002859/26

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2021

**Lënda:** *Rekomandohet plotësimi në mënyrë të qartë e të kuptueshme të dokumenteve mjekësore të lëshuara nga mjekët dhe marrja e masave për kalimin për aq sa është e mundur nga përshkrimi me shkrim dore i tyre, në formë elektronike.*

**MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

Tiranë

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BURGJEVE**

Tiranë

**DREJTORISË SË SHËRBIMIT SPITALOR**

Korçë

*Të nderuar,*

Në Institucionin e Avokatit të Popullit është regjistruar ankesa të dënuarit me burgim E. M., i cili fillimisht pretendonte se kishte kërkuar të vizitohej nga një mjek specialist, pasi vuante nga dhimbje në vesh, por kjo kërkesë nuk ishte realizuar. Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, ky i dënuar na është drejtuar sërish me ankesë lidhur me shërbimin mjekësor për problemet me veshin, duke pretenduar se nuk po merrte trajtimin e duhur mjekësor. Sipas ankuesit, ai ka qenë i detyruar të dërgojë në një spital privat CD-në me pamjet e CT-krani për t'i lexuar për arsye se konstatimet e mjekut të Spitalit Rajonal Korçë i janë fshehur, duke marrë vetëm shpjegim verbal se nuk kishte gjë. I dënuari na ka vënë në dispozicion

një kopje të konsultës së CT-krani të spitalit privat, që sipas tij i ka shërbyer mjekut ORL për të bërë një vlerësim më të saktë të gjendjes dhe për të rekomanduar kryerjen e një ekzaminimi shtesë, atë të rezonancës.

Për verifikimin e këtyre pretendimeve, në kuadër të hetimit administrativ, nga ana jonë i është kërkuar informacion dhe dokumentacion Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Korçë dhe Spitalit Rajonal Korçë.

Referuar informacionit që na kanë dhënë këto dy institucione dhe shënimeve të lëna në kartelën e të dënuarit E. M. nga mjekët, me të cilët ai është konsultuar, rezulton si më poshtë vijon:

I dënuari E. M. në datën 02.10.2020 ka kryer vizitë me mjekun specialist ORL në Spitalin Rajonal Korçë, pasi më parë ai ka refuzuar terapinë me antibiotikë dhe alkool boric që ka rekomanduar mjekja psikiatër e IEVP Korçë, sipas ankesës që referonte ky i dënuar. Për arsye të pandemisë Covid-19, referuar masave shtesë kufizuese të vendosura në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të përballuar këtë situatë, jashtë institucioneve mund të dilnin për konsulta dhe ekzaminime vetëm të burgosurit që përbënin urgjencë mjekësore. IEVP Korçë na ka vënë në dispozicion shënimet e lëna nga mjeku ORL në konsultën e datës 02.10.2020, shënime, të cilat për shkak të shkrimit nuk kuptohen qartë. Referuar shpjegimit të IEVP Korçë, mjeku ORL i Spitalit Rajonal Korçë ka shkruar: *“Gjendja e përgjithshme është e mirë. Pacienti referon dhimbje veshi dhe zhurmë. Nga pamja me otoskop gjendja duket normal. I është dhënë mjekim sprajt”*. Poshtë shënimit të mjekut ORL, mjekja e IEVP-së ka shënuar se të dënuarit i është dhënë mjekim me alkool boric, por ai ka refuzuar.

Ndërsa, Spitalit Rajonal Korçë nga ana jonë i është kërkuar të na informojë<sup>1</sup> mbi arsyen se përse është vlerësuar nga mjeku ORL që pacienti E. M. të trajtohet me sprajt dhe përse nuk është shënuar lloji i sprajtit që duhet të përdorej si dhe kohëzgjatja e kurës. Lidhur me këto pyetje, Spitali Rajonal Korçë na ka kthyer përgjigje vetëm pasi kemi kërkuar ndërhyrjen e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për mungesë bashkëpunimi<sup>2</sup>. Shpjegimi i dhënë nga Spitali Rajonal Korçë është si vijon: *“I dënuari E.*

---

<sup>1</sup>Shkresat me Nr.K2/E23-5 Prot., datë 20.10.2020, Nr.K2/E23-8 Prot., datë 04.11.2020, Nr.K2/E23-9 Prot., datë 22.12.2020.

<sup>2</sup> Shkresat me Nr.K2/E23-10 Prot., datë 25.02.2021 dhe Nr.K2/E23-12 Prot., datë 16.04.2021.

*M. ka kryer konsultë në datën 02.10.2020 dhe kemi marrë informacion nga mjeku kurues se pacienti shfaq zhurmë në vesh me Atroskop, pamja normale dhe provat e dëgjimit në normë. Nga ana e mjekut i është dhënë në përdorim sprai Nazal Esonide për 15 ditë”. Kjo përgjigje është shoqëruar edhe me një shpjegim me shkrim dore të mjekut ORL T. M., i cili shprehet se pacienti ka referuar për bllokim të hundës dhe një nga arsyet e zhurmave në vesh është pikërisht bllokimi i hundës. Për këtë arsye është rekomanduar përdorimi i sprajt nazal. Në datën 25.03.2021, E. M.ka realizuar CT-krani të veshit në Spitalin Rajonal Korçë. Shënimet me dorë lidhur me konstatimet e këtij ekzaminimi janë lënë në kartelën klinike të të dënuarit, ku në fund të tyre ndodhet një nënshkrim, por konstatohet se mungon emri i mjekut radiolog që ka bërë përshkrimin dhe vula e tij. Në kartelën klinike është administruar edhe konsulta e mjekut të spitalit privat lidhur me CT-kranin që i dënuari ka kryer në Spitalin Rajonal Korçë, e cila është e përpiluar në formë elektronike dhe në fund gjendet emri i mjekut radiolog dhe vula e tij. Më tej, i dënuari E. M. ka vijuar me konsultë ORL në Spitalin Rajonal Korçë në datën 27.04.2021, konsultë ORL në Qendrën Spitalore “Nënë Tereza” në datën 06.05.2021 si dhe ka kryer rezonancë manjetike (RM të kockës temporale dextra) në datën 01.07.2021. Përshkrimi i rezultateve të RM koke është dhënë në formë elektronike, ku në fund të dokumentit ndodhet emri i mjekut specialist me nënshkrimin e tij, i cili ka konstatuar një gjendje normale.*

Për këtë rast, ashtu sikurse kemi vepruar edhe gjatë hetimit të ankesave të tjera të të burgosurve të ardhura në institucionin tonë që kanë të bëjnë me trajtimin e tyre shëndetësor, kemi vlerësuar të nevojshëm këqyrjen e kartelës klinike. Në këtë mënyrë për të verifikuar pretendimet e ankuesve krijohet një tablo më e qartë mbi veprimet e kryera nga stafi përkatës i administratës së IEVP-së. Evidentojmë faktin se, në të gjitha rastet kemi hasur vështirësi për të kuptuar në mënyrë të qartë e të plotë të gjitha shënimet e lëna nga mjekët, si nga mjekët/infermierët e IEVP-ve ashtu dhe mjekët specialistë të spitaleve ku të burgosurit janë dërguar për konsulta dhe ekzaminime specifike. Ndhimëskomisioneri i ngarkuar me hetimin e ankesave gjatë verifikimit në IEVP të dokumentacionit, ka kërkuar nga mjeku apo infermieri i IEVP-së që të lexojë shënimet dhe në kushtet e mirëbesimit ka raportuar informacionin që i është thënë. Në ndonjë rast është konstatuar se edhe vetë mjeku që i ka lënë shënimet ka patur vështirësi për t’i lexuar ato, veçanërisht kur ka kaluar kohë e gjatë nga dita e lënies së këtyre shënimeve.

Edhe në kartelën klinike të të dënuarit E. M. kemi ndeshur me të njëjtin problematikë dhe për këtë arsye ka qenë e domosdoshme t'i drejtohem i IEVP Korçë dhe të kërkojmë të na referojë në përgjigje përshkrimet e mjekut, pavarësisht se na ishte vënë në dispozicion dokumenti ku ishin lënë këto shënime. Sikurse kuptohet qartë nga komunikimi shkresor që kemi patur me IEVP Korçë dhe Spitalin Rajonal Korçë, mjeku i IEVP-së i ka dhënë për mjekim të dënuarit medikamentin *alkool boric spraj* (mjekim që është refuzuar), pas konsultës së datës 02.10.2020, pa shpjegim të kohëzgjatjes së përdorimit dhe aplikimit të dozës, ndryshe nga rekomandimi i mjekut ORL, i cili shprehet se i dënuari duhet të përdorte *spraj Nazal Esonide* për 15 ditë. Në vlerësimin tonë, kjo mund të ketë ndodhur edhe për shkak të shënimeve të pa kuptueshme me shkrim dorë të lëna nga mjeku specialist.

Nisur nga problematikat e sipërpërmendura, çmojmë se dokumentet e kartelës klinike të pacientit nuk janë ekskluzivitet i mjekut që i përpilon ato. Shënimet duhet të jenë të lexueshme nga çdo mjek, staf shëndetësor, autoritet që ka kompetencë të njihet me të dhënat e pacientit, familjarë si dhe nga vetë pacienti. Në Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, të hartuar nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Mjekëve, në zbatim të nenit 4/2/b dhe nenit 20 të Ligjit Nr.123/2014 “Për urdhrin e mjekëve në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohen rregulla të qarta lidhur me shënimet që lihen në kartelën klinike.

Në nenin 27/paragrafi i dytë, 34 dhe 35 të Kodit parashikohet si më poshtë vijon:

#### **“Neni 27**

##### ***Procedura diagnostikuese e mjekuese***

*Mjekut nuk i lejohet që me përshkrimin e tij, të rrezikojë në mënyrë të pajustificuar shëndetin dhe jetën e të sëmurit. Ai duhet t'i formulojë përshkrimet e tij në përputhje me udhëzuesit klinikë dhe protokollet e miratuara, në mënyrë të qartë e të kuptueshme për pacientin dhe për të tjerët.*

#### **Neni 34**

##### ***Dokumentimi i veprimeve mjekësore***

*Të gjitha veprimet diagnostikuese e mjekuese që kryen në praktikën klinike në çdo lloj shërbimi dhe profili ambulator, spitalor, publik a privat, mjeku i përshkruan (regjistron) në dokumentat mjekësore të posaçme, të cilat ruhen e mirëmbahen në përputhje me dispozitat që aplikon institucioni shëndetësor në kushtet e respektimit dhe të ruajtjes së sekretit profesional.*

*Mjeku e ka për detyrë të krijojë Dosjen (kartelën) klinike individuale të të sëmurit, e cila plotësohet dhe ruhet nën përgjegjësinë e mjekut kurues si një dokument i rëndësishëm klinik, studimor-shkencor dhe juridik (mjeko-ligjor). Ai e ka për detyrë të përshkruajë në kartelën klinike qartë e kuptueshëm diagnozat, ekzaminimet dhe interpretimet e tyre, mjekimet dhe argumentat për çdo ndryshim që bën, si dhe konsultat mjekësore që kryhen për të sëmurin e tij.*

### ***Neni 35 – Lëshimi i dokumentave mjekësore***

*Në praktikën mjekësore është e domosdoshme bërja e dokumenteve mjekësore, certifikata, epikriza, dëshmi, etj dhe lëshimi i tyre me kërkesë të të sëmurit, familjarëve ose organeve kompetente të njohura me Ligj.*

*Çdo dokument që plotëson dhe lëshon mjeku duhet të hartohet në mënyrë korrekte, plotësisht në përputhje me konstatimet mjekësore, të jetë i lexueshëm, ku të mund të identifikohet nënshkruesi dhe firma e tij*”.

Shqetësimin lidhur me shënimet jo të qarta dhe të pakuptueshme të mjekëve, e kemi ngritur edhe më parë, kur kemi shqyrtuar rastin e të dënuarit G. K. (pacient që i është nënshtruar një operacioni dhe ka bërë transplant veshke). Në përfundim të hetimit të ankesës lidhur me trajtimin e tij mjekësor, me shkresën Nr.K2/S30-15 Prot., datë 13.12.2019, ndër të tjera, i kemi rekomanduar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, plotësimin në mënyrë të lexueshme të dokumenteve të lëshuara nga mjekët gjatë kryerjes së praktikës klinike në çdo lloj shërbimi dhe profil ambulator apo spitalor. Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” nuk na ka kthyer një përgjigje, megjithëse kemi kërkuar të informohemi mbi masat e marrë në zbatim të rekomandimit tonë me shkresën Nr.K2/S30-18 Prot., datë 28.02.2020. Edhe dy kërkesat<sup>3</sup> tona për ndërhyrje, për të siguruar bashkëpunimin e QSU “Nënë Tereza”,

<sup>3</sup> Shkresat Nr.K2/S30-19 Prot., datë 06.07.2020 dhe Nr.K2/S30-2 Prot., datë 22.10.2020.

drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë, kanë rënë në heshtje. Ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, lidhur me këtë rekomandim shprehet se: *“Janë marrë masa duke ju tërhequr vëmendje stafit shëndetësor në sistemin e burgjeve, për plotësimin, përshkrimin dhe shënimeve në dokumentacionet përkatëse, kartelat klinike të tyre apo regjistrat e nd/mjekëve në mënyrë të qartë e korrekte. Dihet që personeli mjekësor përdor edhe terma latinisht e shquhet për kaligrafi të pakuptueshme – gjithsesi deri tani nuk kemi konstatuar raste për këtë shkak (shkrimin të pakuptueshme) të ketë patur raste të keqinformimit për mënyrën e trajtimit të tyre”*<sup>4</sup>.

Pavarësisht se shënimet (kaligrafia) jo të qarta dhe të pakuptueshëm të mjekëve merren të mirëqena dhe shpesh trajtohet me shaka, ky fakt mund të ketë pasoja me ndikim për jetën dhe shëndetin e pacientëve. Shkrimi (kaligrafia) i pakuptueshëm mund të çojë në keqkuptime të stafit shëndetësor. Leximi, e më tej zbatimi i gabuar i shënimeve mund të sjellë si pasojë mjekimin e gabuar apo dhënien e dozës së gabuar duke rrezikuar në mënyrë të pajustificuar shëndetin dhe jetën e të sëmurit. Nëse një farmacist ose infermier nuk mund të lexojë qartësisht përshkrimet dhe mjekimet e përcaktuara në një recetë, mund të ketë nevojë të marrë konfirmim nga mjeku përkatës për kuptimin e recetës, çka mund të shkaktojë vonesë në kohë në trajtimin me medikamente të pacientit. Një mjek që nuk mund të lexojë qartësisht një recetë, ekzaminim apo çdo dokument tjetër, pjesë e praktikës mjekësore mund t'i duhet të presë derisa të kontaktojë me personin që ka lënë shënimet për të marrë një përgjigje shteruese. Këto lloj vonesash në kohë mund të jenë të rrezikshme e të pajustificuara, veçanërisht në një situatë urgjence mjekësore. Përshkrimet me shkrim dore duhet të jetë gjithmonë e më shumë diçka e së kaluarës dhe stafi shëndetësor duhet të shfrytëzojë mundësitë që ofron teknologjia në ditët e sotme duke kaluar në formën e përshkrimit elektronik. Plotësimi i dokumentacionit mjekësor në mënyrë elektronike është një mënyrë më e qartë, e kuptueshme dhe e sigurtë komunikimi, e cila jo vetëm do të shmangë gabimet, por do të përbëjë edhe një bazë të dhënash që çdo pacient akseson, e ruan ndër vite dhe i referohet kur ka nevojë për to.

Të vetëdijshëm për ngarkesën, në veçanti atë psikologjike që ka personeli mjekësor kur ushtron detyrën, posaçërisht gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, dhe kohës së kufizuar që ata kanë në dispozicion krahasuar me numrin e pacientëve, të cilët duhet t'i dëgjojnë, trajtojnë, t'u japin konsulencën e nevojshme, tërheqim vëmendjen se lënia e

---

<sup>4</sup> Shkresa Nr.10480/1 Prot., datë 10.01.2020, pika 3.

shënimeve në mënyrë jo të qartë e të kuptueshme në dokumentet mjekësorë ka efekt të kundërt me qëllimin, për të cilin ato plotësohen. Ndaj do të duhet të merren masat e nevojshme për të adresuar gjetjet tona në funksion të përmirësimit të praktikës së përshkrimit të veprimeve dhe konstatimeve të stafit mjekësor në dokumentet mjekësore.

Bashkëlidhur rekomandimit do të gjeni fotokopje të dokumenteve si më poshtë:

- Shënimet e mjekut ORL të Spitalit Rajonal Korçë që ka vizituar të dënuarin E. M. në datën 02.10.2020 dhe shënimet e mjekes së IEVP Korçë lidhur me zbatimin e rekomandimit të mjekut specialist.
- Shënimet e lëna në kartelën klinike të të dënuarit E. M. në datën 25.03.2021 nga mjeku i Spitalit Rajonal Korçë lidhur me CT-krani që ka kryer ky i dënuar.
- Shënimet e lëna nga doktori radiolog i spitalit privat, i cili ka përshkruar CT-krani të të dënuarit E. M. të kryer në Spitalin Rajonal Korçë, në datën 25.03.2021.

Dokumentet mjekësorë që po ju vëmë në dispozicion janë një shembull i dhjetëra praktikave që kemi këqyrur ndër vite, gjatë shqyrtimit të ankesave të të dënuarve lidhur me trajtimin e tyre mjekësor.

Për sa më lart, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut”* si dhe në mbështetje të nenit 21/b të ligjit nr.8454 dt.04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”* i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive.”*

### **REKOMANDOJMË:**

- Marrjen e masave të nevojshme për hartimin e plotësimin në mënyrë të qartë e të kuptueshme të dokumenteve të lëshuara nga mjekët gjatë kryerjes së praktikës klinike në çdo lloj shërbimi dhe profil ambulator apo spitalor.
- Marrjen e masave të nevojshme për kalimin për aq sa është e mundur nga përshkrimi me shkrim dore në atë të plotësimit të dokumentacionit mjekësor në mënyrë elektronike.

- Marrjen e masave të nevojshme nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe strukturat spitalore për të përmirësuar bashkëpunimin me institucionin e Avokatit të Popullit, për të dërguar informacionet si dhe përgjigjet mbi rekomandimet e bëra gjatë trajtimit të rasteve, në funksion të ushtrimit të misioneve tona kushtetuese dhe ligjore.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, na vini në dijeni brenda afatit ligjor 30 ditor, të parashikuar në nenin 22 të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Erinda Ballanca**